

**Letër e hapur
Kryetarit të Komunës së Deçanit z. Rasim Selmanaj**

I nderuari z. Selmanaj,

Fillimisht, dëshirojmë të jua urojmë mandatin e fituar, duke shpresuar që katër vitet e ardhshme do t'i shfrytëzoni për prosperitetin e komunës suaj dhe përmbushjen e premtimeve të dhëna, në bazë të të cilave qytetarët ju kanë dhënë besimin.

Instituti për Studime të Avancuara GAP në bashkëpunim me Rrjetin Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) kanë monitoruar aktivitetet dhe premtimet e juaja, të dhëna gjatë fushatës zgjedhore në periudhën 15 tetor – 14 nëntor 2009. Si rezultat i monitorimit tonë të bërë në mediat e shkruara dhe elektronike, programin e juaj zgjedhor, si dhe në debatin tuaj të mbajtura në "Jeta në Kosovë", ju keni premtuar:

- Ofrimin e shërbimeve sa më afër qytetarëve duke vënë në funksion zyrat ndihmëse në periudha kohore kur paraqitet nevoja;
- Zgjidhjen në afat ligjor të kërkesave të qytetarëve drejtuar administratës;
- Transparencë të plotë;
- Garantimin e ligjshmërisë dhe mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve;
- Hartimin dhe miratimin e një strategjie për luftimin e korrupsionit;
- Udhëheqjen dhe menaxhim cilësor e efikas të sistemit të arsimit;
- Përmirësimin e cilësisë së të hyrave, procesit dhe arritjeve në shkolla;
- Krijimin e hapësirave të mjaftueshme dhe të shëndetshme për mësimdhënie dhe nxënie;
- Rritjen e sigurisë në shkolla dhe jashtë tyre;
- Gjithëpërfshirjen e fëmijëve dhe të rinjve në sistemin e arsimit;
- Mirëmbajtjen permanente të infrastrukturave në objektet shkollore ;
- Promovimin e produkteve bujqësore;
- Ngritjen e kapaciteteve për ruajtje-deponim dhe përpunim të pemëve dhe perimeve;
- Investimet dhe subvencionet në blegtori me qëllim të nxitjes së fermerëve në kultivimin e racave produktive;
- Rehabilitimin e sistemit të ujitjes në të gjitha sipërfaqet bujqësore;
- Investimet në bletari, me synim të shtimit dhe përpunimit të prodhimeve bletare;
- Zhvillimin e Agro-turizmit rural dhe malorë me produkte ekologjike;
- Subvencionim të bujqve të komunës përmes sigurimit të farërave, serave, sigurimit të trajnimeve dhe ligjëratave nga ekspert vendor dhe të huaj;
- Promovimin e produkteve të bujqve vendor, duke organizuar panaire dhe forma tjera të marketingut;
- Ndërtimin e kanaleve të ujitjes në fshatin Isniq;
- Mbrojtjen e pyjeve (parandalimin e prerjeve ilegale, mbrojtjen nga zjarret, mbrojtjen nga sëmundjet fitosanitare);
- Shfrytëzimin e pyjeve (shfrytëzimin e masës drunore dhe shfrytëzimin e produkteve dytësore);
- Kultivimin e pyjeve (rrallimet parakomerciale dhe komerciale, pyllëzimet e sipërfaqeve të zhveshura, ngritja e një fidanishte për prodhimin e fidanëve);

- Angazhimin e rreth 500 punëtorëve sezonal dhe dhjetëra punëtorëve të rregullt në mbrojtje dhe kultivim të pyjeve;
- Dyfishimin e rojeve në pyll;
- Formimin e drejtorisë së pyjeve;
- Investimet kapitale në vlerë rreth 2 milion euro (30% me shumë se në vitin 2009);
- Rritjen e të hyrave dhe investimeve për 25-30% për secilin vit, nga 2010-2013;
- Investimet në rregullimin e problemit të ujit të pijshëm, ujërave të zeza;
- Investimet në rrugë, trotuare dhe ndriçim publik;
- Riparimin dhe mirëmbajtjen e objekteve arsimore, shëndetësore, kulturore, sportive dhe sociale;
- Sportelet e veçanta në kohën e verës kur diaspora kthehet për pushime;
- Punë edhe jashtë orarit të rregullt në kohën e verës;
- Rishikimin e mundësisë së shkurtimit të afateve për rregullim dokumentacionit;
- Tavolinën ndihmëse apo kujdestarinë elektronike për bashkatdhetarë;
- Takimin tradicional vjetor “Deçani dhe diaspora”;
- Sigurinë e plotë në investimet e diasporës qoftë në sektorin privat apo partnerit me komunën, përmes Agjencionit për Konsulencë;
- Ofrimin e lokaliteteve apo pronave të caktuara publike me koncesion, në përputhje me dispozitat ligjore;
- Formimin e zyrës për këshillime juridike dhe ekonomike, në sferën e investimeve, kreditimit, etj.
- Numrin telefonik dhe email adresën e posaçme për kontakte;
- Krijimin e kushteve për funksionim normal të institucioneve të kulturës – Shtëpisë së Kulturës, Teatrit, Sallës së Filmit, Bibliotekës, Arkivit etj.);
- Shfrytëzimin e objekteve të kulturës, të cilat tani nuk janë duke u shfrytëzuar;
- Organizimin e manifestimeve kulturore, artistike letrare;
- Mbështetjen e organizimeve tjera që ndërmerren nga OJQ-të për manifestime kulturore;
- Kujdesin e vazhduar ndaj monumenteve të trashëgimisë kulturore;
- Definimin e formës për ndërtimin dhe shfrytëzimin e të gjitha objekteve sportive, në bashkëpunim me Qeverinë, Klubet sportive dhe Shoqërinë Civile;
- Ndërtimin e Sallës Sportive dhe Stadiumit të Qytetit;
- Ndarjen e çmimit për sport “Ruzhdi Ramosaj”;
- Përkrahjen e klubeve sportive dhe ndarjen e buxhetit për to;
- Organizimin e Kupës së Deçanit në gara me ski, dhe disiplina të tjera sportive;
- Organizimin e ngjarjeve sportive për shënimin e datave të rëndësishme;
- Riaktivizimin e të gjitha klubeve me nam që kanë qenë në Decan (“Klubin Futbollistik të Decanit” dhe “Klubin Futbollistik Besa” nga Reznici, në vjeshtën e ardhshme);
- Ndarjen e 30 mijë eurove për ndërtimin e stadiumit të futbollit në fshatin Jezniq;
- Sigurimin e sa më shumë bursave për nxënës dhe studentë të suksesshëm;
- Punësimin sezonal për të rinjtë;
- Organizimin e rrjetit vullnetar të të rinjve pranë Komunës;
- Organizimin e manifestimeve tradicionale si: Festivali muzikorë për të rinj, Audicioni për aktor të rinj, etj.;
- Organizimin e debateve lidhur me temat rinore;
- Subvencionimin e bujqësisë;

- Përmirësimin e infrastrukturës rrugore dhe ndërlidhjen e mirë të sistemit të rrugëve në të gjitha qendrat e banuara dhe në vendet e përcaktuara për kapacitete prodhuese;
- Përmirësimin e rrjetit furnizues me energji elektrike;
- Riparimin e kanaleve të ujitjes: Decan-Carrabeg-Prilep; Qendra e Decanit- Rruga e Demonstratave; Ura e Demës-Isniq-Prapaqan; Dubovik-Papaq; Pobergjë-Voksh; Lloqan-Carrabreg dhe Decan-Beleg;
- Hidrocentralet e reja në Lumëbardhin e Deçanit dhe Llozanit;
- Menaxhimin e pasurive ujore për bujqësi;
- Rritjen e mundësive të punësimit të përhershëm dhe sezonal;
- Identifikimin e bizneseve joformale dhe legalizimin e tyre;
- Implementimin e mjekësisë familjare në të gjitha qendrat e saj në nivel komunal;
- Ngritjen e cilësisë së shërbimeve mjekësorë dhe kujdes për qytetarin 24 orë;
- Kujdesin e veçantë për invalidët e luftës, familjarët e dëshmorëve dhe personat me aftësi të kufizuara;
- Furnizimin e institucioneve shëndetësore me material shpenzues dhe medikamente;
- Pajisjet laboratorike, si renga dhe filma RG;
- Ndërtimin e objektit të Rtg diagnostifikues;
- Rregullimin e rrethojave të ambulancës dhe riparimin e tyre;
- Kontrollimin permanent dhe inspektimin e rregullt të artikujve ushqimorë;
- Përmirësimin e gjendjes sociale në bashkëpunim me MPMS;
- Rishikimin e listave për shfrytëzuesit e përkrahjes sociale dhe pensionistët;
- Përkujdesjen për të pastrehët;
- Përkujdesjen shoqërore për të gjitha kategoritë sociale në bashkëpunim me OJQ-të dhe MPMS;
- Përmirësimin e rrjetit të ujësjellësit, sigurimin e kapaciteteve të reja të ujit dhe përhapjen e rrjeteve të reja në fshatra;
- Sigurimin e një deponie për mbeturinat, në hapësirën afër polit të gështenjave ose në një vend tjetër ku ajo nuk do të jetë pengesë për qytetarët;
- Përmirësimin e shërbimit të zjarrfikësve;
- Rregullimin dhe mirëmbajtjen e parqeve;
- Elektrifikimin e rrugëve të pandriçuara me ndriçim eficient;
- Rregullimin e çështjes së parkingut për taksitë automjete;
- Mirëmbajtjen e lapidarëve të Dëshmorëve të Kombit;
- Mirëmbajtjen dhe modernizimin e rrugëve lokale;
- Sigurimin e automjeteve që do të bëjnë larjen e rrugëve gjatë verës;
- Kontraktimin e kompanive të cilat gjatë sezonit të dimrit do të bëjnë pastrimin e borës;
- Ndërtimin e rrjetit të ujësjellësit në fshatrat Ratish i Epërm dhe Ratishi Poshtëm;
- Vendosjen e sinjalizimit dhe rritjen e sigurisë në komunikacion;
- Rregullimin e stacionit të autobusëve dhe nënstacioneve tjera lokale;
- Krijimin e rrjetit lokal dhe komunal të autobusëve;
- Rritjen e mundësive për parkim - dhënien e parkingjeve me koncesion;
- Kujdestarinë rrugore të automjeteve tek shkollat fillore dhe të mesme në kohën e fluksit të nxënësve (në bashkëpunim me Policinë e Kosovës);
- Vendosjen e barrierave të komunikacionit në rrugët dytësore të frekuentuara me qytetarë, e sidomos nxënës filloristë;

- Përfshirjen në planin strategjik të zhvillimit të turizmit në bjeshkët e: Gjeravices, Junikut, Deçanit, Prilepit, Isniqit, Baballoqit, Kurvallës dhe në përgjithësi Bjeshkët e Nemuna;
- Kërkesën e vazhduar për përfundim të projektit nacional të rrugës Deçan-Plavë;
- Ndërtimin e objekteve hoteliere shëruese dhe rehabilituese;
- Mbajtjen e Javës së trashëgimisë kulturore, prezantimin e tradicionales, traditës burimore, dhe lojërave të vjetra me rëndësi për zhvillimin e turizmit;
- Hartimin e katalogut turistik komunal;
- Ndërtimin e fshatit turistike në fshatin e Bellës;
- Realizimin e projektit e stazave të skijimit në Bjeshkët e Belegut;
- Ndërtimin e fshatit Olimpik në Bjeshkët e Belegut;
- Ndërtimin e teleferikut në Bjeshkët e Nëmura;
- Hapjen e punëtorive të vogla për ruajtjen e traditës sonë të pasur të artizanaleve punim dore si: qylymat, saxhadet, çantat e krahut, cakullat, si edhe punime e veshje të ndryshme të Rajonit të Rrafshit të Dukagjinit etj.;
- Implementimin PZHU (Plani Zhvillimor Urban);
- Ujësjetësin unazor për 10 fshatra dhe ujësjetësin në zona tjera si Isniq, regjion i Vokshit, Kodrali, etj.;
- Hulumtimin e një lokacioni për ndërtimin e tregut të gjelbër;
- Rregullimin e trotuareve dhe fushave me gjelbërim në zonat e banuara;
- Hapjen e rrugëve të reja në qytet duke u bazuar ne PZHIU – synimi perëndim dhe lindje;
- Rregullimin e shtratit të Lumëbardhit me ale anësore të ndriçuara dhe shëtitore;
- Legalizimin e objekteve të banimit të cilat nuk e prishin Planin Rregullativ Urban dhe plotësojnë standardet ndërtimore dhe largimin atyre të cilat janë në kundërshtim me Planin Rregullativ.
- Ndërtimin e çerdhes për fëmijë;
- Asfaltimin e rrugëve anësore në zonat rurale;
- Ndriçimin e rrugëve të banuara në qytet dhe zona rurale;
- Ndërtimin e rrugës transit;
- Hartimin e planit rregullativ për zonën urbane dhe implementimin e tij;
- Formimin e agjensionit për hartim dhe projektim;
- Avancimin e femrës në sektorët e vendim marrjes;

Për fund, ju bëjmë me dije se Instituti GAP dhe BIRN, në fund të çdo viti kalendarik, do të dalin me raporte vlerësuese rreth përmbushjes së premtimeve të dhëna nga kryetarët e komunave.

Ju urojmë qeverisje të suksesshme dhe shpresojmë në bashkëpunimin tuaj edhe në të ardhmen.

Sinqerisht,

Instituti për Studime të Avancuara GAP
Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuëse (BIRN)